



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE DHE
ZHVILLIMIT TË INDUSTRIËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NË FUSHËN
E MINIERAVE DHE INDUSTRIËS**

Nr. 7166/18 prot.

Tiranë, më 08.10.2019

Lënda: Njoftim për fillim procedurash revokimi të lejes nr.1808, datë 01.07.2016.

SHOQËRISË “SS & R” SH.P.K
Lagjia Nr.1, Rruga Minatori, Banesa Private nr.42, Prrenjas, Qarku Elbasan

Për dijeni: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE
Blloku “Vasil Shanto”, Nr.18, Tiranë.

AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE EMERGJENCAT NË MINIERA
Rruga “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë.

Shoqëria “SS & R” sh.p.k është zotëruese e lejes minerare të shfrytëzimit nr.1808, datë 01.07.2016, për mineral kromi, në objektin “Skroskë”, Prrenjas, Qarku Elbasan.

Nga struktura përgjegjëse e AKBN-së me shkresën nr.4832, datë 29.07.2019, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me nr.7166, datë 31.07.2019, është propozuar revokimi i lejes nr.1808, datë 01.07.2016, për mineral kromi, në objektin “Skroskë”, Prrenjas, Qarku Elbasan, sepse nuk keni paguar garancinë financiare të rehabilitimit të mjedisit për vitin 2018 - 2019, duke mos respektuar kërkesat e nenit 31, të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe akteve nënligjore që kanë dalë në zbatim të tij.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve, është i mbështetur në germën “ç” të pikës 1, të nenit 47, (neni që përcakton shkeljet ligjore për të cilat një leje revokohet), të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Sa më sipër, në zbatim të nenit 48, të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare të shfrytëzimit nr.1808, datë 01.07.2016, për mineral kromi, në objektin “Skroskë”, Prrenjas, Qarku Elbasan, që shoqëria juaj zotëron.**

Ju bëjmë me dije se, pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do të merret vendimi për revokimin e lejes minerare të shfrytëzimit nr.1808, datë 01.07.2016, për mineral kromi, në objektin “Skroskë”, Prrenjas, Qarku Elbasan.

Në zbatim të nenit 49, të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, duhet të rehabilitoni zonën e shfrytëzimit në të cilën keni ushtruar aktivitet minerar.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin!

MINISTRI

BELINDA BALLUKU

ME AUTORIZIM

ZËVENDËSMINISTRI

ILIR BEJTJA

